



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1696/3 Prot.

Durrës, më 11.11.2022

VENDIM

Nr. 51, datë 11.11.2022

"Miratimin e pagesës së orëve mësimore të realizuara mbi mësimdhënien e normuar vjetore jashtë auditorit për vitin akademik 2021 -2022 nga personeli akademik me kohë të plotë i fakulteteve të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës"

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 268, datë 29.3.2017, për disa ndryshime në Vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë" të ndryshuar, Udhëzimi nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", shkresës nr. 1664 prot, datë 07.11.2022 të Drejtorisë së Administrimit Financiar, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e pagesës në masën deri në 200 orë mësimore të lejueshme mbinormë jashtë auditorit për vitin akademik 2021-2022 nga personeli akademik me kohë të plotë i fakulteteve të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, sipas udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë".
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Drejtoria e Administrimit Financiar
 - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDI TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

